



Datë: 21.07.2025
Numër Protokolli: 5266/2025

A.nr.926/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Atdhe Gashi- në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.926/2025 të datës 21.05.2025, të parashtruar nga ankueset J.F-L dhe L.G, kundër organit të punësimi/Agjencia për Informim dhe Privatësi, në çështjen juridike “*Kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.926/2025 e datës 21.05.2025, e parashtruar nga ankueset J.F-L dhe L.G.

A r s y e t i m

Nëpunëset civile, J.F-L dhe L.G (në tekstin e mëtejme referuar Ankueset), më datë 21.05.2025 kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 3373/2025, e regjistruar në emrin e ankueses J.F-L, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.38/2025 të datës 29.04.2025, të Drejtoreshës së Përgjithshme së Agjencisë për Informim dhe Privatësi, ndërsa me datë 29.05.2025 ankueset kanë plotësuar ankesën e datës 21.05.2025, kundër Njoftimit me numër protokolli 599 të datës 28.05.2025, të Menaxheres së Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Informim dhe Privatësi.

Kryetari I Këshillit pas pranimit të kërkesës së Kryetarit të Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, përmes Vendimit VK/2025 dhe numër protokolli 4517/2025, të datës 04.07.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.926/2025 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe referuar pretendimeve ankimore të parashtruara nga ankueset, ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Kolegji i Këshillit, nga administrimi i provave të lëndës ka gjetur se ankueset janë të punësuar në Departamentin për Qasje në Dokumente Publike, pranë Agjencisë për Informim dhe Privatësi me, gjegjësisht ankuesja J.F-L sipas Akt emërimit me numër protokolli 498 të datës 22.05.2024 ushtron pozitën e punës *Zyrtare në Divizionin Raportim dhe Monitorim*, Klasa Profesional 2 , I14, Koeficienti 5.2. ndërsa ankuesja L.G sipas Akt emërimit me numër protokolli 501 të datës 22.05.2024 ushtron pozitën e punës *Zyrtare e Lartë në Divizionin për Raportim dhe Monitorim*, Klasa Profesional 1, I12, Koeficienti 5.75.

Si për rrjedhojë, ankueset përmes shkresës me numër protokolli 1143 të datës 16.12.202, i janë drejtuar me kërkesë organit të punësimit, përmes të cilës kanë kërkuar ekuivalentimin e pozitave të tyre me pozitat e inspektorëve, mirëpo të njëjtat nuk kishin pranuar përgjigje në raport me kërkesën e tyre, ashtu që për shkak të heshtjes administrative të organit të punësimit, ankueset me datë 21.05.2025 kishin parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Tutje Këshilli, përmes Vendimit me numër A.nr.289/2025 të datës 14.04.2025, kishte detyruar Drejtoreshën e Përgjithshme të Agjencisë për Informim dhe Privatësisë, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi të shqyrtoj Kërkesën me numër protokolli 1143 të datës 16.12.2024 të parashtruar nga ankueset, dhe të nxjerr akt administrativ në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi, ndërsa kjo e fundit me Vendimin me Nr.38/2025 të datës 29.04.2025, ka obliguar Menaxheren e Personelit në organin përkatës të punësimit, të ndërmarrë veprimet për zbatimin e vendimit të Këshillit. Menaxherja e Personelit në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, me datë 28.05.2025 ka nxjerrë Njoftimin me numër protokolli 599, lidhur me njoftimin e veprimeve të ndërmarra nga organi i punësimit, përmes së cilit theksohet se Agjencia për Informim dhe Privatësi në shkurt të vitit 2024, ka filluar plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr.01/2021 për organin e brendshëm dhe se aktualisht është në proces dhe se ndryshimi i koeficienteve sipas kërkesës së ankuesve mund të bëhet përmes ndryshimeve në strukturën organizative.

Ankueset, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendojnë se organi i punësimit ka aplikuar gabimisht të drejtën materiale, për shkak të diskriminimit në aspektin e pagës së njëjtë për punën e njëjtë, mos veprimit dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike si dhe mos zbatimit të Vendimit të Këshillit dhe pranimi të së drejtës së tyre. Andaj, kërkojnë aprovimin e ankesës si të bazuar me detyrimin që Drejtoresha e Përgjithshme e Agjencisë për Informim dhe Privatësisë, të rregullojë koeficientet e tyre në shtatë (7) sipas pozitës Inspektorëve, duke kompensuar të njëjtat në mënyrë retroaktive që nga data 01.02.2023 e hyrjes në fuqi e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik .

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueseve, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: ”1. *Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj*”, dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: 3.

Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Agjencia për Informim dhe Privatësi ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procedimi i pozitave të ankueseve në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tyre të punës, në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit përkatës për Zyrtarët Publik dhe Rregullores përkatëse për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i zbatimit të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Kosovës lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve me qëllim të llogaritjes së pagës bazë.

Andaj, duke qenë se organi përkatës i punësimit në këtë rast Agjencia për Informim dhe Privatësi, nuk ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës sikurse përcaktohet me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, në fuqi nga data 28.02.2024, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e parashtruar nga ankueset, është e parakohshme, dhe si e tillë në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritior. Rrjedhimisht, e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës së theksuar më lart, ankueseve do t'i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankesës për klasifikimin e pozitës së tij të punës.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.926/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësueses së autorizuar, ankueses J.F-L;
- Agjencisë për Informim dhe Privatësi (Drejtoreshës së Përgjithshme dhe Menaxheres së Burimeve Njerëzore); si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.